



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË
ARSIMIN E LARTË**

**Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të
Lartë në Shqipëri**

**Raporti i Akreditimit Periodik Institucional
të Universitetit Politeknik të Tiranës**

MAJ 2021

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

- Grant Horsburgh Kryetar
- Prof. Florim Grajcevci Anëtar
- Prof. Ana Mane Anëtar

Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë mase institucionet e arsimit të lartë (IAL-të) përmbushin Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri që hynë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është një proces i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që janë të specializuar në të njëjtën fushë, dhe çdo grup vlerësimi përbëhet nga një ndërthurje e vlerësuesve nga Mbretëria e Bashkuar të caktuar nga QAA dhe të vlerësuesve shqiptarë të caktuar nga ASCAL-i. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga një vlerësues ekspert i arsimit të lartë nga Mbretëria e Bashkuar.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-të, por edhe për t'iu ofruar IAL-ve, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesit që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxëniet të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë krerë, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Së fundi, vlerësuesit e përmyllin procesin duke rekomanduar një gjykim përmbledhës për Bordin e Akreditimit të ASCAL-it. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, ASCAL-i i ka ofruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm këshilla dhe asistencë të specializuar, duke u siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe duke korrigjuar dhe përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) ka zanafillën e tij inxhinierike me themelimin e Institutit të Lartë Politeknik në Tiranë në vitin 1951. Në vitin 1957, bashkimi i gjashtë instituteve të inxhinierisë solli formimin e Universitetit Shtetëror të Tiranës nga ku diplomoheshin inxhinierë në katër fusha. UPT u themelua në vitin 1991 me katër fakultete të inxhinierisë. Riorganizimi i vitit 2007 sollti shtimin e dy fakulteteve të tjera dhe ngritjen e dy instituteve të cilat më pas u bashkuan në vitin 2011. Në vitin 2013, u shtua një fakultet tjetër. UPT është i vetmi universitet i inxhinierisë në Shqipëri.

Në vitin 2002, programet e studimit u ristrukturuan duke marrë parasysh parimet e Procesit të Bolonjës. Programet e studimit u prezantuan në dy cikle: Bachelor në ciklin e parë dhe Master në ciklin e dytë, ku programet e Masterit ndahen në programe të Masterit Profesional të orientuar në punë ose programe të Masterit të Shkencave. Në vitin 2009 u prezantuan programet e studimit të ciklit të tretë në nivel doktorature.

UPT-ja është pjesë e një sërë rrjetesh të njohura akademike dhe ka krijuar marrëdhënie me mbi 50 institucione të arsimit të lartë nga 87 vende në mbarë botën. Në vend, UPT-ja ka krijuar lidhje me disa shoqëri prestigjioze në mbarë Shqipërinë dhe rajonin më gjerë.

Në kohën e këtij Vlerësimi të Jashtëm, UPT-ja përbehet prej 8 njësive kryesore (Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, Fakulteti i Inxhinierisë së Informacionit dhe Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit) si dhe 30 njësi bazë. Ky universitet ka edhe 32 njësi administrative. Universiteti ka 605 punonjës, nga të cilët 366 janë staf akademik me kohë të plotë, 124 staf akademik mbështetës dhe 106 staf administrativ. UPT-ja ofron këto programe: 21 programe Bachelor (cikli i parë), 43 programe Master (cikli i dytë), 10 programe doktorature (cikli i tretë) dhe pesë programe të studimit të vazhdueshëm. Për vitin akademik 2019-20, kishte 8500 studentë aktivë të regjistruar në UPT. **[SED, f. 2-5; Informacioni i ASCAL për IAL në faqen e vlerësimit]**

Raporti përmbledhës

Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) është i vetmi universitet i inxhinierisë në Shqipëri (Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, Fakulteti i Inxhinierisë së Informacionit), një qendër kërkimore (Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit) dhe 32 departamente administrative. UPT-ja ofron këto programe: 21 programe të ciklit të parë; 20 Mastera Profesionalë; 23 Mastera të Shkencave, dhe 10 programe doktorature. Aktualisht, UPT-ja punëson 366 staf akademik me kohë të plotë, dhe për vitin akademik 2019-20, kishte 8500 studentë aktivë.

Ky është Vlerësimi i dytë Institucional për UPT-në, për të vlerësuar se deri në çfarë shkalle janë përmbushur Standardet Shtetërore të Cilësisë, që hynë në fuqi në vitin 2011. Raporti i vlerësimit të parë të jashtëm në muajin shtator të vitit 2016 nuk përfshiu asnjë karakteristikë të praktikës së mirë, dha 16 rekomandime që UPT-ja të merrte parasysh për trajtimin e fushave të identifikuara të pikave të dobëta dhe konfirmoi pesë veprime në proces e sipër. Raporti përcaktoi gjykimet e mëposhtme për secilën Fushë Vlerësimi:

- Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përmbushur kryesisht**.
- Standardet për Burimet janë **përmbushur kryesisht**.
- Standardet për Kurrikulën janë **përmbushur plotësisht**.
- Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përmbushur kryesisht**.
- Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përmbushur kryesisht**.

Në dhjetor të vitit 2016 vlerësuesit i rekomanduan Bordit të Akreditimit se UPT-ja i kishte **përbushur kryesisht** Standardet Shtetërore të Cilësisë dhe për rrjedhojë Bordi i dha UPT-së akreditim trevjeçar.

Raporti i Vetëvlerësimit u hartua nga Grupi i Punës së Vetëvlerësimit të Brendshëm që përfshiu 10 persona nga universiteti me njohuri të thella të institucionit, dhe një përfaqësues të këshillit studentor. Përpara se të finalizoheshin, projektraportet iu shpërndanë një audience më të gjerë në universitet. Senati Akademik autorizoi lëshimin e raportit përfundimtar dhe dërgimin e tij në Agjenci.

Vizita zgjati dy ditë, në datat 1 dhe 2 prill 2021. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy ekspertë të nivelit të lartë për arsimin e lartë, nga Mbretëria e Bashkuar, dhe dy anëtarë me përvojë në arsimin e lartë, pjesë e stafit të institucioneve të Shqipërisë dhe Kosovës. Ndonëse vlerësuesit shqiptarë ishin prezent në UPT gjatë vizitës, Kryetari nga Mbretëria e Bashkuar mori pjesë online. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Menaxheri për Vlerësimin e Jashtëm dhe një mbajtës shënimesh i punësuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mori Raportin e Vetëvlerësimit dhe portofolin me të dhënat mbështetëse katër javë përpara vizitës së Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, më pas i plotësuar me dokumentacion shtesë, përpara dhe gjatë vizitës. Një gamë e gjerë informacioni mbështetës, e siguruar nga UPT, i mundësoi grupit të njihej me strukturën, politikat dhe procedurat e menaxhimit, dhe me natyrën e mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore të ndërmarrë nga institucioni. Këto dokumente përfshinin Statutin dhe Rregulloret, raportet e brendshme, raportin vjetor për Ministrinë, procedurat e pranimit dhe udhëheqjes, listën e marrëveshjeve të jashtme dhe memorandumeve, shembujt e informacioneve rreth programit, si dhe dokumentet e mbledhjeve vendimmarrëse.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me menaxherë të nivelit të lartë, studentë, pedagogë, personelin administrativ dhe mbështetës, si dhe partnerë të jashtëm gjatë vizitës së vlerësimit të jashtëm. Diskutimet ndihmuan në qartësimin e procedurave, përgjegjësisve dhe gjetjeve. Në të gjitha mbledhjet u mbajtën shënime.

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimi e tij janë **përbushur kryesisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, grupi i vlerësimit nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë. Megjithatë u identifikuan dy pika të dobëta: Njësia e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë nuk është ngritur plotësisht pasi disa vende vakante në nivel fakulteti mbeten të paplotësuara (**Kapitulli III, Standardi I.4**); Zyra e Karrierës dhe Alumni nuk është ngritur plotësisht pasi disa vende vakante mbeten të paplotësuara (**Kapitulli III, Standardi III.1; Kapitulli III, Standardi III.2**). Për rrjedhojë, janë bërë dy **rekomandime** për adresimin e plotë të rekomandimeve të bëra pas vizitës së shtatorit 2016: që UPT-ja të trajtojë si çështje parësore ngritjen e plotë dhe nivelet e personelit të kërkuar për të mbështetur një Njësi plotësisht funksionale të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në mbarë institucionin si një mjet për zhvillimin dhe zbatimin e një mekanizmi që nxit promovimin dhe zotërimin e një kulture të cilësisë në të gjitha njësitë dhe të gjitha nivelet dhe zhvillimin e procedurave të duhura të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë akademike. (**Kapitulli III, Standardi I.4**); që UPT-ja të trajtojë si çështje parësore ngritjen e plotë dhe nivelet e personelit

të kërkuar për të mbështetur një Zyrë plotësisht funksionale të Karrierës dhe Alumni, si një mjet për të krijuar një Shoqatë Alumni për të diplomuarit e saj dhe për të monitoruar në mënyrë qendrore vendet dhe rezultatet e punësimit të të diplomuarve (**Kapitulli III, Standardi III.1; Kapitulli III, Standardi III.2**). Meqenëse Raporti i Vetëvlerësimit pranoi se zhvillimi i një politike afatgjatë për përmirësimin e numrit të studentëve ndërkombëtarë dhe ekspertëve akademikë hyrës në të gjitha departamentet dhe fakultetet mbetet një sfidë, **rekomandohet** që UPT-ja të vijojë me zhvillimin e strategjisë së saj të ndërkombëtarizimit për të siguruar që mundësitë e mobilitetit për stafin dhe studentët dhe integrimin e studentëve dhe stafit të huaj mund të realizohen në mënyrë efektive. (**Kapitulli III, Standardi III.4**). Raporti i Vetëvlerësimit tregoi gjithashtu një aspiratë për të promovuar trajnime të mëtejshme profesionale afatshkurtra. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rikonfirmon** këtë aspiratë dhe inkurajon UPT-në të ndërmarrë veprime për promovimin e trajnimeve të mëtejshme profesionale afatshkurtra në bashkëpunim me rrjetin e partnerëve të jashtëm. (**Kapitulli III, Standardi III.1; Kapitulli III, Standardi III.2**). Gjatë procesit të vlerësimit UPT-ja ofroi evidenca të mjaftueshme për të dëshmuar angazhimin e saj në trajtimin e çështjeve të diskutuara në raportin që rezulton nga vizita e akreditimit e shtatorit të vitit 2016. Si rrjedhojë, grupi i vlerësimit të jashtëm ishte në gjendje të konfirmonte se dy pikat e dobëta dhe rekomandimet e dhëna, të identifikuar për Fushën e Vlerësimit 1, janë adresuar plotësisht.

Standardet për Burimet janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, grupi i vlerësimit të jashtëm nuk vuri në dukje ndonjë veçori të praktikës së mirë ose nuk identifikoi ndonjë pikë të dobët, por **rekomandoi** që UPT-ja të monitorojë rregullisht të gjitha faqet e internetit të fakulteteve në nivel institucional për të siguruar që informacioni i ofruar është konsistent, i qartë, i përditësuar dhe i saktë. (**Kapitulli III, Standardi VII.1**). Në hapësirat ku nuk është i mundur aksesimi për personat me aftësi të kufizuara është hartuar një plan veprimi për të trajtuar këtë mangësi dhe grupi i vlerësimit të jashtëm **rikonfirmon** veprimin e propozuar nga UPT-ja për të siguruar që të gjithë studentët, dhe veçanërisht personat me aftësi të kufizuara, të jenë në gjendje të kenë akses të plotë dhe të pakufizuar në hapësirat e institucionit. (**Kapitulli III, Standardi VII.3; Kapitulli III, Standardi VII.5; Kapitulli III, Standardi V.1**). Gjatë procesit të vlerësimit UPT-ja ofroi evidenca të mjaftueshme për të dëshmuar angazhimin e saj në trajtimin e çështjeve të diskutuara në raportin që rezulton nga vizita e akreditimit e shtatorit të vitit 2016. Si rrjedhojë, grupi i vlerësimit të jashtëm arriti të konfirmonte se tre pikat e dobëta dhe tre rekomandimet e dhëna, të identifikuar për Fushën e Vlerësimit 2, janë adresuar plotësisht.

Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë, nuk identifikoi asnjë dobësi, nuk dha asnjë rekomandim apo nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë. Gjatë procesit të vlerësimit UPT-ja ofroi evidenca të mjaftueshme për të dëshmuar angazhimin e saj në trajtimin e çështjeve të diskutuara në raportin që rezulton nga vizita e akreditimit e shtatorit të vitit 2016. Si rrjedhojë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti të konfirmonte se tre pikat e dobëta dhe tre rekomandimet e dhëna, të identifikuar për Fushën e Vlerësimit 3, janë adresuar plotësisht.

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë, nuk identifikoi asnjë dobësi, nuk dha asnjë rekomandim apo

nuk pohoi asnjë veprim tashmë të ndërmarrë. Gjatë procesit të vlerësimit UPT-ja ofroi evidenca të mjaftueshme për të dëshmuar angazhimin e saj në trajtimin e çështjeve të diskutuara në raportin që rezulton nga vizita e akreditimit e shtatorit të vitit 2016. Si rrjedhojë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti të konfirmonte se katër rekomandimet e identifikuar për Fushën e Vlerësimit 4 janë adresuar plotësisht.

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi një veçori të **praktikës së mirë**: sigurimi i kujdestarëve individualë për studentët e ciklit të parë me qëllim lehtësimin e ecurisë së tyre përmes programit të tyre duke u ofruar mbështetje kokë më kokë dhe orientim nëpërmjet takimeve formale të paracaktuara. **(Kapitulli I, Standardi III.6)**. Nuk është identifikuar asnjë dobësi, nuk është dhënë asnjë rekomandim ose nuk është pohuar asnjë veprim tashmë i zbatuar. Gjatë procesit të vlerësimit UPT-ja ofroi evidenca të mjaftueshme për të dëshmuar angazhimin e saj në trajtimin e çështjeve të diskutuara në raportin që rezulton nga vizita e akreditimit e shtatorit të vitit 2016. Si rrjedhojë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti të konfirmonte se tre pikat e dobëta dhe tre rekomandimet e dhëna, të identifikuar për Fushën e Vlerësimit 5 janë adresuar plotësisht.

UPT-ja Kapitulli vetëvlerësimin në përputhje me udhëzimet e ASCAL-it. Grupi i vlerësimit vlerësoi shkallën e angazhimit të Universitetit në proces dhe bashkëpunimin që iu ofrua përgjatë fazës së vizitës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga Z. Grant Horsburgh (Drejtues), Prof. Florim Grajcevcu dhe Prof. Ana Mane (Anëtarë).

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- sigurimi i kujdestarëve individualë për studentët e ciklit të parë për të lehtësuar ecurinë e tyre përmes programit të tyre. **(Kapitulli I, Standardi III.6)**.

Pikat e dobëta

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë nuk është ngritur plotësisht pasi mbeten të paplotësuara disa vende vakante në nivel fakulteti **(Kapitulli III, Standardi I.4)**
- Zyra e Karrierës dhe Alumni nuk është ngritur plotësisht pasi mbeten të paplotësuara disa vende vakante **(Kapitulli III, Standardi III.1; Kapitulli III, Standardi III.2)**.

Rekomandimet

Grupi i vlerësimit të jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- UPT-ja trajton si çështje parësore ngritjen e plotë dhe nivelet e personelit të kërkuara për mbështetjen e një Njësie plotësisht funksionale të Sigurimit të Cilësisë së Brendshme në mbarë institucionin. **(Kapitulli III, Standardi I.4)**
- UPT-ja trajton si çështje parësore ngritjen e plotë dhe nivelet e personelit të kërkuara për mbështetjen e një Zyre plotësisht funksionale të Karrierës dhe Alumni në mbarë institucionin. **(Kapitulli III, Standardi III.1; Kapitulli III, Standardi III.2)**
- UPT-ja vijon të zhvillojë strategjinë e saj të ndërkombëtarizimit për të siguruar që mundësitë e mobilitetit për stafin dhe studentët dhe integrimi i studentëve dhe stafit të huaj të mund të realizohen në mënyrë të efektshme. **(Kapitulli III, Standardi III.4)**
- UPT-ja siguron që të gjitha faqet e internetit të fakulteteve monitorohen rregullisht në nivel institucional për të siguruar që informacioni i ofruar është konsistent, i qartë, i përditësuar dhe i saktë. **(Kapitulli III, Standardi VII.1).**

Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë

Grupi i vlerësimit të jashtëm pohoi veprimin e mëposhtëm të ndërmarrë:

- promovimin e trajnimeve të mëtejshme profesionale afatshkurtra në bashkëpunim me rrjetin e partnerëve të jashtëm; **(Kapitulli III, Standardi III.1; Kapitulli III, Standardi III.2)**
- masën e propozuar nga UPT-ja për sigurimin se të gjithë studentët, dhe personat me aftësi të kufizuara në veçanti, do të kenë akses të plotë dhe të pakufizuar në hapësirat e institucionit. **(Kapitulli III, Standardi VII.3; Kapitulli III, Standardi VII.5; Kapitulli III, Standardi V.1).**

Gjykime përmbledhëse për çdo Fushë Vlerësimi

- Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përmbushur kryesisht.**
- Standardet për Burimet janë **përmbushur plotësisht.**
- Standardet për Kurrikulën janë **përmbushur plotësisht.**
- Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përmbushur plotësisht.**
- Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përmbushur plotësisht.**

Gjykim i përmbledhur

Vlerësuesit i rekomandojnë Këshillit të Akreditimit se Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur plotësisht në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Raport i detajuar

Fusha e vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- Kornizat rregullatore dhe të qeverisjes së UPT-së janë krijuar për t'u bashkënduar me kërkesat ligjore kombëtare për institucionet e arsimit të lartë. **[RVV f. 14&15; Ref.1.01_EN; M 6,7,11&13]** Statuti përcakton misionin, organizimin e brendshëm dhe strukturat drejtuese. **[Ref.1.01_EN, Kapitulli 2]** Në rregullore përcaktohen edhe përgjegjësitë individuale dhe formale të bordit dhe këshillit. **[Ref.1.01_EN, Kapitulli 3]** UPT kryen ndryshime të Statutit dhe rregulloreve të tij sipas nevojës. **[RVV f. 14; M 11]** Bordi i Administrimit dhe Senati Akademik kanë miratuar Statutin duke marrë parasysh ligjin e arsimit të lartë, e konfirmuar edhe nga Ministria Përgjegjëse për Arsimin e Lartë. **[RVV f. 15] (Kapitulli III, Standard I.1)**
- UPT-ja është e organizuar për të siguruar efikasitet në menaxhim në përputhje me kërkesat ligjore dhe *Planin Strategjik 2019-2024*. **[M 6-8,10,11&13]** Rrjedha e informacionit nga departamentet në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit, dhe shpallja e vendimeve të tyre për dijeni të stafit dhe studentëve, është e efektshme. **[M 3-7]** Rregullimet për menaxhimin dhe administrimin e Universitetit dhe vendimmarrjen kolegjiale marrin parasysh pritshmëritë ligjore dhe kuptohen nga të gjithë anëtarët e stafit në të gjitha nivelet. **[RVV f. 15-17; Ref.1.03_EN; Ref.1.05_EN; Ref.1.06_EN; Ref.1.07_EN; Ref.1.08_EN; Ref.1.12] (Kapitulli III, Standardi I.2)**
- Organet drejtuese takohen rregullisht dhe informacionet mbi zërat e rendit të ditës i vihen në dispozicion paraprakisht të gjithë stafit në mënyrë elektronike. **[RVV f. 17&19; M 6&7]** Stafi dhe studentët i kuptojnë rregullimet për funksionimin e këshillave dhe bordeve vendimmarrëse dhe për mbështetjen e diskutimit dhe debatit kolegjial **[RVV f. 17&19; M 3-7] [RVV f. 17&19; M 3-7]** Dekanët dhe përgjegjësit e departamenteve janë të përgjegjshëm për monitorimin lokal të zbatimit të vendimeve të marra nga bordet dhe këshillat e ngritur zyrtarisht. **[M 11] (Kapitulli III, Standardi I.3; Kapitulli III, Standardi II.3)**
- UPT siguron respektimin e kufijve të autonomisë së saj dhe operimin brenda kornizave ligjore dhe rregulloreve në fuqi. **[RVV f. 17; M 11]** Vetëqeverisja është e dukshme në njësitë organizative akademike dhe administrative, veprimtaritë mësimore dhe shkencore, çështjet financiare dhe administrative. **[M 11]** Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka një rol kyç në monitorimin dhe analizimin e efektivitetit të veprimtarive të vlerësimit të brendshëm. **[RVV f. 17]** Ngritja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është projektuar për të adresuar rekomandimin e bërë pas vizitës së akreditimit të shtatorit 2016 për të zhvilluar dhe zbatuar një mekanizëm që nxit promovimin dhe zotërimin e një kulture cilësore në të gjitha njësitë dhe të gjitha nivelet dhe zhvillimin e duhur të procedurave të monitorimit dhe rishikimit të cilësisë akademike **[M 8,11&13] [RVV f. 6; M 8,11&13]** Megjithatë, gjatë vizitës u bë e qartë se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë nuk është ngritur plotësisht pasi mbeten të paplotësuar disa vende vakante në nivel fakulteti dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se kjo ishte një **pikë e dobët**. **[M 8,11&13]** Për adresimin e plotë të rekomandimeve të bëra pas vizitës së akreditimit në shtator 2016 për të zhvilluar dhe zbatuar një mekanizëm që nxit promovimin dhe zotërimin e

një kulturre të cilësisë në të gjitha njësitet dhe të gjitha nivelet dhe zhvillimin e procedurave të duhura të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë akademike, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që UPT-ja të trajtojë si çështje parësore ngritjen e plotë dhe nivelet e personelit të kërkuar për të mbështetur një Njësi plotësisht funksionale të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në mbarë institucionin. **(Kapitulli III, Standardi I.4)**

- UPT ka një strategji të duhur të zhvillimit në formën e *Planit Strategjik 2019-2024*, i cili është miratuar nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. **[RVV f. 17&18; Ref.1.12_EN; M 2&11]** Strategjia është hartuar në përputhje me misionin dhe objektivat e UPT-së dhe është marrë parasysh gjatë fazave të ndryshme të zhvillimit të saj nga organet dhe këshillat drejtues. **[RVV f. 17&18; M 2&11]** Njësitet kryesore dhe ato bazë kanë zhvilluar dhe zbatuar plane veprimi për të përmbushur kërkesat e Strategjisë. **[RVV f. 18; Ref.1.15_EN; M 6,7&11]** Hartimi i *Planit Strategjik 2019-2024* adreson plotësisht rekomandimin e bërë pas vizitës së akreditimit në shtator 2016 për të identifikuar një sërë prioritesh të Universitetit, të mbështetur nga objektivat dhe synimet e duhura që fakulteteve u kërkohet të trajtojnë në planet e tyre të fakultetit dhe departamenteve. **[RVV f. 6&7; Ref.1.12_EN & Ref.1.15_EN]** **(Kapitulli III, Standardi I.5)**

- Raporti vjetor për Ministrinë Përgjegjëse për Arsimin e Lartë paraqet llogaritë e programeve mësimore dhe studimore, kërkimit shkencor, stafit, veprimtarive të projektit dhe çështjeve ekonomike dhe financiare. **[RVV f. 18]** Procesi i hartimit informohet nga vlerësimi i brendshëm dhe raportet e vetëvlerësimit nga çdo Njësi Kryesore dhe Bazë. **[M 8 &13]** Raporti përfundimtar miratohet nga Senati Akademik. **(Kapitulli III, Standardi I.6)**

- Fakultetet dhe departamentet janë organizuar në përputhje me kërkesat ligjore. **[RVV f. 19; Ref.1.02; Informacioni për IAL-të në faqen e interneti të ASCAL; M 6&7]** Strukturat drejtuese, ekzekutive dhe administrative janë të ndara nga strukturat akademike dhe ato organizative. **[M 6&7,11&13]** Stafi akademik është i kualifikuar dhe ushtron autonomi dhe liri akademike në mësimdhënie, kërkim dhe veprimtari të tjera akademike. **[M 6&7,11&13]** UPT-ja ka një faqe interneti zyrtare dhe ofron programe të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në përputhje me statusin e vet ligjor. **[RVV f. 19; Ref.1.02; Informacioni për IAL-të në faqen e interneti të ASCAL; www.upt.al; M 3-5]** **(Kapitulli III, Standardi II.1)**

- UPT ka një rrjet partnerësh në nivel kombëtar dhe rajonal duke përfshirë institucionet e arsimit të lartë, organet publike dhe shoqëritë e pavarura. **[RVV f. 8; RVV f. 20&21; M 3-6,12&13]** Ndërkombëtarizimi përfshihet si një karakteristikë kyçe në *Planin Strategjik 2019-2024*. **[Ref.1.12_EN]** Ndonëse nuk u ofrua asnjë evidencë me shkrim që të tregonte se UPT kryen anketa vjetore për nevojat e tregut të punës siç rekomandohet në raportin nga vizita e akreditimit në shtator 2016, raporti i vetëvlerësimit tregoi se informacioni i përditësuar i tregut të punës merret nëpërmjet kontaktit të vazhdueshëm ndërmjet stafit akademik dhe industrisë. **[RVV f. 8]** Kjo u konfirmua gjatë një takimi me disa partnerë të jashtëm dhe ish-studentë. **[M 12]** Studentët, stafi akademik, ish-studentët dhe përfaqësues të industrisë treguan se ka lidhje të forta midis organizatave lokale dhe rajonale dhe stafit akademik të Njësive Kryesore dhe Bazë. **[M 3-7,11&12]** Lidhjet e forta ndërmjet stafit akademik dhe industrive përkatëse konfirmojnë se rekomandimi për të kryer anketa të tregut të punës për të informuar kurrikulat dhe zhvillimin e

programeve në të gjitha nivelet e studimit është përmbushur plotësisht. Raporti i Vetëvlerësimit tregoi gjithashtu një aspiratë për të promovuar trajnime të mëtejshme profesionale afatshkurtra. **[RVV f. 21]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rikonfirmon** këtë aspiratë dhe inkurajon UPT-në të ndërmarrë veprime për promovimin e trajnimeve të mëtejshme profesionale afatshkurtra në bashkëpunim me rrjetin e partnerëve. **(Kapitulli III, Standardi III.1; Kapitulli III, Standardi III.2)**

- Ngritja e Zyrës së Karrierës dhe Alumni për të monitoruar punësimin e të diplomuarve dhe ngritja e një rrjeti të të diplomuarve janë prezantuar për të marrë në konsideratë rekomandimin e dhënë pas vizitës së parë për të krijuar një Shoqatë Alumni për të diplomuarit e saj dhe për të monitoruar në mënyrë qendrore vendet dhe rezultatet e punësimit të të diplomuarve. **[RVV f. 8; RVV f. 20]** Megjithatë, gjatë vizitës u bë e qartë se Zyra e Karrierës dhe Alumni nuk është ngritur plotësisht pasi një numër vendesh vakante mbeten të paplotësuara, të cilin Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konstatoi si një **pikë të dobët**. **[M 8,10&13]** Për të adresuar plotësisht rekomandimin e bërë pas vizitës së akreditimit të shtatorit 2016 për ngritjen e një Shoqate Alumni për të diplomuarit e saj dhe për të monitoruar në mënyrë qendrore vendet dhe rezultatet e punësimit të të diplomuarve, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që UPT-ja të trajtojë si çështje parësore ngritjen e plotë dhe nivelet e personelit të nevojshëm për të mbështetur një Zyrë plotësisht funksionale të Karrierës dhe Alumni. **(Kapitulli III, Standardi III.1; Kapitulli III, Standardi III.2)**

- UPT ka lidhur marrëveshje partneriteti me institucione shtetërore dhe private për të ofruar shërbime për studentët dhe për të siguruar që programet e tij të studimit përmirësohen dhe përshtaten për të përmbushur nevojat dhe pritshmëritë e tyre. **[RVV f. 8; RVV f. 21; M 6,7&11-13]** Çdo Njësi Bazë menaxhon mbikëqyrjen e marrëveshjeve të partneritetit. **[RVV f. 21; M 6,7&11]** **(Kapitulli III, Standardi III.3)**

- Universiteti ka lidhur një sërë marrëveshjesh zyrtare duke i mundësuar stafit dhe studentëve pjesëmarrjen në aktivitete ndërkombëtare. **[RVV f. 21&22; M 3-7,11&12]** Raporti nga vizita e akreditimit në shtator 2016 vuri në dukje se UPT kishte nivele modeste të mobilitetit hyrës dhe dalës, ku mobiliteti i studentëve hyrës përbënte një sfidë të veçantë. Gjithashtu, UPT-së i mungonte aftësia institucionale për të ofruar programe studimi në gjuhët ndërkombëtare si anglishtja dhe në raport u theksua se ofrimi i programeve të studimit në gjuhë ndërkombëtare si dhe një politikë afatgjatë e mobilitetit do të ishte e dobishme. Si rrjedhojë, UPT-së iu rekomandua që të zhvillojë një politikë afatgjatë për përmirësimin e numrit të studentëve ndërkombëtarë dhe ekspertëve akademikë hyrës në të gjitha departamentet dhe fakultetet. Raporti i Vetëvlerësimit pranon se kjo çështje mbetet një sfidë për UPT-në. **[RVV f. 22; M 11]** Ndaj, rekomandohet që UPT-ja të vijojë me zhvillimin e strategjisë së saj të ndërkombëtarizimit për të siguruar që mundësitë e mobilitetit për stafin dhe studentët dhe integrimi i studentëve dhe stafit të huaj të mund të realizohen në mënyrë të efektshme. **(Kapitulli III, Standardi III.4)**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë në këtë Fushë Vlerësimi.

Pikat e dobëta

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë nuk është ngritur plotësisht pasi mbeten të paplotësuara disa vende vakante në nivel fakulteti **(Kapitulli III, Standardi I.4)**
- Zyra e Karrierës dhe Alumni nuk është ngritur plotësisht pasi mbeten të paplotësuara disa vende vakante **(Kapitulli III, Standardi III.1; Kapitulli III, Standardi III.2)**.

Rekomandimet

Grupi i vlerësimit të jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- UPT-ja trajton si çështje parësore ngritjen e plotë dhe nivelet e personelit të kërkuara për mbështetjen e një Njësie plotësisht funksionale të Sigurimit të Cilësisë së Brendshme në mbarë institucionin. **(Kapitulli III, Standardi I.4)**
- UPT-ja trajton si çështje parësore ngritjen e plotë dhe nivelet e personelit të kërkuara për mbështetjen e një Zyre plotësisht funksionale të Karrierës dhe Alumni në mbarë institucionin. **(Kapitulli III, Standardi III.1; Kapitulli III, Standardi III.2)**
- UPT-ja vijon të zhvillojë strategjinë e saj të ndërkombëtarizimit për të siguruar që mundësitë e mobilitetit për stafin dhe studentët dhe integrimi i studentëve dhe stafit të huaj të mund të realizohen në mënyrë të efektshme. **(Kapitulli III, Standardi III.4)**

Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë

Grupi i vlerësimit të jashtëm pohoi veprimin e mëposhtëm të ndërmarrë:

- promovimin e trajnimeve të mëtejshme profesionale afatshkurtra në bashkëpunim me rrjetin e partnerëve të jashtëm; **(Kapitulli III, Standardi III.1; Kapitulli III, Standardi III.2)**

Vendimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

- UPT-ja ka zhvilluar dhe zbaton politika progresive të rekrutimit të stafit akademik. Struktura organizative diskutohet dhe miratohet në Senatin Akademik dhe miratohet nga Bordi i

Administrimit. [RVV f. 23&24; Ref.1.02_EN; M 6,7,11&13] Tabela e strukturës organizative është publikuar në faqen zyrtare të internetit. [www.upt.al] Brenda strukturës së përgjithshme të miratuar, rolet e stafit akademik dhe administrativ janë paraqitur në detaje. RVV f. 23&24; Ref.2.01_EN] Rekrutimi në njësitë akademike bazohet në analizën e nevojave specifike për fakultetin, departamentin, programin e studimit dhe kurrikulën dhe nëse roli është me kohë të plotë apo të pjesshme. Vendet vakante bëhen publike nëpërmjet portalit online. [http://upt.al/vendepune] Procesi i rekrutimit për stafin akademik, shkencor dhe administrativ ndjek të njëjtin proces të përcaktuar në Statut dhe Rregullore të cilat marrin parasysh ligjin përkatës. [RVV f. 23&24; Ref.1.01_EN; Ref.1.03_EN] Ngrihet një komision për shqyrtimin e aplikimeve të kandidatëve, vlerësimi bëhet në bazë të meritave individuale dhe kontrata e punës nënshkruhet nga Rektori. Në përputhje me natyrën specifike të institucionit, stafi akademik aktual përbëhet nga profesionistë të kualifikuar në fusha teknike specifike të inxhinierisë. **(Kapitulli III, Standardi IV.1; Kapitulli III, Standardi II.2)**

- UPT-ja angazhohet për zbatimin e politikave integruese të stafit akademik dhe administrativ të përcaktuara në *Planin Strategjik 2019-2024*. [RVV f. 25; Ref.1.12_EN; M 6,7&11] Stafi mbështeti mendimin e shprehur në raportin e vetëvlerësimit se, krahas mësimdhënies, stafi akademik është i angazhuar në një sërë veprimtarish, të tilla si seminare, aktivitete dhe organizime sociale. [RVV f. 25; Ref.2.09_EN; M 6,7&11] Pas tërmetit të nëntorit 2019, stafi akademik u angazhua në terren për të ndihmuar në vlerësimin e shkallës së dëmit të shkaktuar. Më pas, stafi akademik hartoi një sërë raportesh studimore dhe në vitin 2020, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit organizoi një simpozium ndërkombëtar për të eksploruar efektet e tërmetit. [Ref.2.15-EN; http://isdee-al.com] Në bashkëpunim me studentët, stafi akademik përfshihet në aktivitete jashtëshkollore dhe sociale. [Ref.3.33_EN; M 6,7&11] **(Kapitulli III, Standardi IV.2)**

- Objektivat strategjike të zhvillimit të stafit janë të përcaktuara në *Planin Strategjik 2019-2024* dhe UPT ndjek një politikë të edukimit të vazhdueshëm të stafit në përputhje me këta objektiva. [RVV f. 25&26; Ref.1.12_EN; Ref.1.24_EN; M 6,7&11] Stafit akademik i ofrohet mbështetje duke u mundësuar atyre të marrin pjesë në aktivitete trajnuese në institucione të tjera dhe jashtë vendit. [RVV f. 26; Ref.2.08_EN] Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Titujve Akademikë përgatit dhe promovon stafin akademik për tituj të avancuar akademik në përputhje me kërkesat staturore. [RVV f. 26; Ref. 2.35] **(Kapitulli III, Standardi IV.3)**

- UPT ka organizuar një gamë të gjerë aktiviteteve për të nxitur dialogun social ndërmjet stafit, studentëve dhe komunitetit në përgjithësi. [RVV f. 26&27; Ref.2.10_EN; Ref.2.11_EN; M 3-7] Shembujt përfshijnë, aktivitete sociale, fushatën javore të ndërgjegjësimit dhe ditët e hapura për studentët e ardhshëm. Stafi akademik është përfshirë në një sërë konferencash dhe studentët janë angazhuar me institucionet lokale në projekte të tilla si projekti “Akademia 100+ Fshatrat” në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit. [RVV f. 26&27; Ref.2.09_EN] Për më tepër, publikimi periodik i UPT-së, *Buletini i Shkencave Teknike* përfshin artikuj që ofrojnë kontribute shkencore në fushat teknike. [http://www.upt.al/botime] UPT gjithashtu jep një kontribut social përmes pjesëmarrjes në legjislacionin e reformave të arsimit të lartë, si dhe projekteve

strategjike si trashëgimia kulturore, kodet e ndërtimit dhe kontributet në zhvillimin e zonave industriale nga e kaluara. **[RVV f. 26&27; Ref.2.16_EN] (Kapitulli III, Standardi IV.4)**

- UPT ushtron autonomi financiare në përputhje me rregullat dhe standardet e programimit buxhetor dhe menaxhimit të financave publike. **[RVV f. 27-29; Ref.1.01_EN; Ref.2.21_EN; Ref.4.11_EN; M 1,6,7&11]** Bordi i Administrimit miraton buxhetin i cili hartohet nga Administratori, dhe stafi konfirmoi se çështjet buxhetore diskutohen në të gjitha bordet dhe komisionet përkatëse në njësitë bazë dhe kryesore dhe në Senatin Akademik. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se buxheti financiar për vitin 2021 është miratuar nga Bordi i Administrimit. Duke qenë se menaxhimi financiar dhe kontrolli buxhetor janë të centralizuar, njësitë akademike nuk zotërojnë autonomi të plotë financiare. Megjithatë, transparenca sigurohet nëpërmjet diskutimit të çështjeve financiare në Senatin Akademik, ku marrin pjesë stafi dhe përfaqësuesit e studentëve. Procesi i hartimit të buxhetit dhe sistemi i menaxhimit administrativ financiar është i mirëstrukturuar, efikas dhe i njohur për stafin. **[RVV f. 28; Ref.2.20_EN; M 11]** Në përputhje me kërkesat statutoare, UPT-ja i është nënshtruar auditimeve të brendshme periodike. **[RVV f. 29; Ref. shtesë 6]** Informacioni financiar është i disponueshëm për publikun në faqen e internetit të UPT-së dhe në portalin U-Transparenca. **[RVV f. 28&29; www.upt.al; <https://u-transparenca.al/#buxheti>] (Kapitulli III, Standardi VI.1; Kapitulli III, Standardi VI.2; Kapitulli III, Standardi VI.3)**

- UPT-ja posedon një sistem të koordinuar të menaxhimit të informacionit. Krahas faqes kryesore të internetit, secili fakultet ka një faqe interneti të veçantë për studentët dhe stafin. **[RVV f. 10,11&30-33; www.upt.al]** Ndërsa faqja e internetit e institucionit ofron një përmbledhje gjithëpërfshirëse dhe informacion strategjik, faqet e internetit të fakulteteve ofrojnë të dhëna, informacion dhe njoftime publike lidhur me nevojat akademike të Njësive Bazë dhe Kryesore. **[RVV f.10,11&30-33; www.upt.al]** Ndërsa shumica e faqeve të internetit të fakulteteve ofrojnë informacion përkatës dhe aktual, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se disa prej tyre nuk u ofrojnë studentëve informacion në lidhje me studimet e tyre, aktivitetet sociale ose rrjetet e të diplomuarve. Me qëllim adresimin e plotë të rekomandimit të bërë pas vizitës së akreditimit të shtatorit 2016 për zhvillimin dhe zbatimin e një sistemi të menaxhimit të informacionit i cili siguron prezantim të plotë, të saktë dhe të qartë të informacionit në nivel programi, cikli, Njësie Bazë, Njësie Kryesore dhe institucional **rekomandohet** që UPT-ja të monitorojë rregullisht faqet e internetit të fakulteteve në nivel institucional për të siguruar që informacioni i dhënë është konsistent, i qartë, i përditësuar dhe i saktë. **(Kapitulli III , Standardi VII.1)**

- UPT-ja është e angazhuar me zhvillimin e infrastrukturës së saj digjitale në mbështetje të mësimnxënies së studentëve dhe zhvillimit profesional të stafit akademik. **[RVV f. 32; Ref.1.02_EN; Ref.4.07_EN; M 3-7&11]** Kështu, shumica e veprimtarive institucionale janë të disponueshme në formë elektronike, duke përfshirë shërbimet e protokollit dhe arkivimit, sistemet e bibliotekave dhe një platformë e-Learning e krijuar për të lehtësuar mësimin në distancë. **[RVV f. 32; Ref.2.25; <https://fau.easy-web.cloud/?crd=8870>; M 3-7&11]** Ndonëse në momentin e vizitës UPT-ja nuk ofronte programe të mësimin në distancë, gjatë pandemisë së vitit 2020, i gjithë mësimi u zhvillua online. UPT-ja ofron një sërë laboratorësh kompjuterash të pajisur me harduerët përkatës për mbështetjen e mësimnxënies së studentëve dhe procesit të mësimdhënies në përgjithësi **[RVV f. 30-33; Ref.2.28_EN; M 3-7&11]** Stafi dhe studentët u shprehën se kompjuterat

dhe softuer-et e ofruara nga UPT-ja janë të përshtatshme për nevojat e tyre. **[M 3-7,11&12] (Kapitulli III, Standardi VII.2)**

- UPT-ja ka të regjistruar prona të paluajtshme në gjashtë zona të Tiranës. **[RVV f. 34-37; Ref.2.31_EN; M 11]** UPT-ja monitoron ngushtë përdorimin e burimeve sipas kërkesave për mësimdhënie dhe kërkime. **[RVV f. 34-37; Ref.2.28_EN; Ref.2.32_EN]** Godinat e nxjerra jashtë përdorimit pas tërmetit të vitit 2019 po rindërtohen nën menaxhimin e Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës me qëllim ofrimin e mjediseve moderne mësimore dhe kërkimore. **[RVV f. 34-37; Ref.1.12_EN; Ref.2.18_EN; Ref.2.28_EN; Turi në burimet e të nxënimit]** Investimi vjetor siguron që infrastruktura e UPT-së mbahet në standardin e kërkuar dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm komentoi për cilësinë e akomodimit të të nxënimit dhe që objektet dhe aksesit për individët me aftësi të kufizuara në përgjithësi plotësojnë kërkesat ligjore. **[Turi në burimet e të nxënimit]** Në hapësirat ku nuk është i mundur aksesit për personat me aftësi të kufizuara është hartuar një plan veprimi për adresimin e kësaj mangësie. **[RVV f. 38; Ref.2.40_EN]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rikonfirmon** veprimin e propozuar nga UPT-ja për të siguruar që të gjithë studentët, dhe veçanërisht personat me aftësi të kufizuara, të kenë aksesit të plotë dhe të pakufizuar në hapësirat e institucionit. **(Kapitulli III, Standardi VII.3; Kapitulli III, Standardi VII.5; Kapitulli III, Standardi V.1)**

- UPT-ja ka një trashëgimi të fortë akademike dhe kulturore dhe arkivon botime nga stafi akademik, ndërsa tezat e doktoraturës dhe diplomës të prodhuara nga studentët, ruhen në Bibliotekën Shkencore. Ka sisteme efektive të menaxhimit të koordinuar për të siguruar kujdesin dhe ruajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe informacionit, duke përfshirë të dhënat e studentëve të mbajtura nga Sekretaritet Mësimore. **[RVV f. 35&36; Ref.1.03_EN; Ref.1.04_EN; M 6,7&11]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se objektet e ruajtjes dhe arkivimit brenda bibliotekave si dhe në mënyrë elektronike përmbushin pritshmëritë e sektorit. **[Turi në burimet e të nxënimit] (Kapitulli III, Standardi VII.4; Kapitulli III, Standardi V.2)**

- Zhvillohen veprimtari mësimore dhe të kërkimit shkencor si dhe ofrohen shërbime me interes të përbashkët me palë të treta të jashtme. **[RVV f. 37; Ref.2.23; M 3-7,11 &12]** Laboratorët brenda njësive akademike ofrojnë shërbime për institucionet e jashtme dhe drejtpërdrejt për organizatat përkatëse të tregut të punës nëpërmjet marrëveshjeve që marrin parasysh rregulloret institucionale. **[Ref.2.23_EN]** Hulumtimi i tregut për stazhet e studentëve ka informuar angazhimin me partnerë të jashtëm. **[Ref.5.18_EN]**. Partnerët e jashtëm dhe të diplomuarit konfirmuan se UPT-ja mban kontakte me palë të treta të jashtme për qëllime të veprimtarive mësimore dhe të kërkimit shkencor si dhe shërbimeve me interes të përbashkët. **[M 12] (Kapitulli III, Standardi VII.6)**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë në këtë Fushë Vlerësimi.

Pikat e dobëta

Grupi i vlerësimit nuk identifikoi asnjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandimet

Grupi i vlerësimit të jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- UPT-ja monitoron rregullisht të gjitha faqet e internetit të fakulteteve në nivel institucional për të siguruar që informacioni i ofruar është konsistent, i qartë, i përditësuar dhe i saktë. **(Kapitulli III , Standardi VII.1)**

Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë

Grupi i vlerësimit të jashtëm pohoi veprimin e mëposhtëm të ndërmarrë:

- masën e propozuar nga UPT-ja për sigurimin se të gjithë studentët, dhe personat me aftësi të kufizuara në veçanti, do të kenë akses të plotë dhe të pakufizuar në hapësirat e institucionit. **(Kapitulli III, Standardi VII.3; Kapitulli III, Standardi VII.5; Kapitulli III, Standardi V.1)**

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

- UPT-ja ofron programe të studimeve në përputhje me misionin dhe kapacitet e tij. Universiteti ofron 74 programe në të tre ciklet e studimit Bachelor, Master dhe doktoraturë. Lëndët ofrohen nga fakultetet në fusha të veçanta inxhinierike. **[RVV f. 5&42-61; Ref.1.12_EN; Ref.3.14_EN; Ref.3.15_EN; Ref.3.16_EN; Ref.3.17_EN; Ref.3.18_EN; Ref.3.19_EN; M 3-7,11&12]** UPT-ja siguron që kurrikulat hartohen për të ndihmuar ecurinë e të nxënësve të studentëve gjatë gjithë programit të tyre. Hartimi i kurrikulës siguron që studentët e vitit të parë të fitojnë njohuri të përgjithshme në lidhje me programin e tyre dhe t'i mbështesin ato nëpërmjet shkrimit akademik dhe krijues, ndërsa studentët e vitit të dytë dhe të tretë marrin njohuri të thelluara për fushat e tyre specifike të studimit. **[Ref.2.10_EN, [Ref.2.25_EN, M 3, 4, 5, 7&10]** Detajet e secilit program, për shembull qëllimet, objektivat, struktura e kursit dhe vlerat e krediteve janë të disponueshme në faqet e internetit të fakultetit të cilat janë të aksesueshme përmes faqes kryesore të internetit. **[www.upt.al]** Studentët pohuan se informacioni në faqen e internetit i ndihmoi ata që të zgjidhnin programin e tyre të studimit **[M 3-5]** Programet e studimit në të tre

ciklet përfshijnë shkencë teknike të cilat plotësojnë kërkesat e tregut të punës dhe u ofrojnë studentëve kompetencat e nevojshme për t'i përgatitur për punësim. **[RVV f. 42-61; Ref.3.14_EN; Ref.3.15_EN; Ref.3.16_EN; Ref.3.17_EN; Ref.3.18_EN; Ref.3.19_EN; M 3-7,11&12]** Procesi i pranimit është i përcaktuar qartë, i publikuar në broshura dhe në faqen e internetit, i kuptueshëm nga studentët dhe të gjithë kandidatët trajtohen në mënyrë të drejtë dhe vlerësohen sipas meritës, duke përfshirë arsimin e mëparshëm, provimet shtetërore dhe testet e organizuara nga njësitë akademike. **[RVV f. 44; Ref.1.12_EN; Ref.3.05_EN; Ref.3.06_EN; Ref.3.08_EN; M 3-7] (Kapitulli I, Standardi I.1; Kapitulli I, Standardi I.3; Kapitulli I, Standardi I.6)**

- UPT-ja ofron mundësi për edukim të vazhdueshëm të cilat janë miratuar duke marrë parasysh kërkesat e tregut të punës, për shembull, Vlerësimi i Pasurive të Paluajtshme dhe Auditimi i Energjisë - Proceset dhe Ndërtesat. Të gjitha programet e studimit të ciklit të parë mundësojnë vazhdimin e studimeve në një program shkencor ose profesional të ciklit të dytë. Gjithashtu është i mundur edhe kalimi drejt një studimi në nivel doktore. **[RVV f. 47&48; Ref.3.21_EN; M 3-7] (Kapitulli I, Standardi I.2)**

- Programet e studimit janë hartuar në përputhje me procesin e Bolonjës në lidhje me strukturën, nivelin dhe kreditet. **[RVV f. 49; Ref.3.14_EN; Ref.3.15_EN; Ref.3.16_EN; Ref.3.17_EN; Ref.3.18_EN; Ref.3.19_EN; M 3-7,11&12]** Programet e studimit marrin parasysh plotësisht politikën kombëtare pasi përmbajtja e programit ofron mundësi mobiliteti për studentët dhe stafin. **[RVV f. 49; Ref.2.08_EN; Ref.3.32_EN; Ref.5.03_EN; M 3-7,11&12]** Studentët dhe stafi konfirmuan se mundësitë ndërkombëtare të mobilitetit janë të disponueshme dhe se në disa raste është e disponueshme edhe ndihma financiare. **[M 3-7&11]** Rregulloret e UPT-së mundësojnë dhënien e një diplome të dyfishtë ose të shumëfishtë. **[RVV f. 48; Ref.1.01_EN; Ref.1.20_EN; M 6,7&11] (Kapitulli I, Standardi I.4)**

- UPT-ja e konsideron kapacitetin lidhur me infrastrukturën, punësimin e stafit dhe financat si pjesë të procesit të hartimit të programeve të reja. Secili departament planifikon mësimdhënien në baza vjetore, sipas akteve nënligjore aktuale, dhe në fund të vitit raporton për performancën kundrejt planit. **[RVV f. 50; Ref.3.12_EN; Ref.3.24_EN; M6,7&11]** Çdo mësim shtesë nga stafi me kohë të plotë ose të pjesshme financohet tërësisht nga Universiteti. **[RVV f. 50]** Stafi akademik lidh marrëveshje vjetore ku përcaktohet koha e shpenzuar për mësimdhënie, punë kërkimore dhe detyra të tjera. **[RVV f. 50; M 6,7&11]** Disa prej stafit akademik kanë detyra administrative dhe angazhimet e tyre individuale të mësimdhënies reduktohen sipas rastit. **[RVV f. 50; M 6,7&11] (Kapitulli I, Standardi I.5)**

- Të gjitha programet e ciklit të parë mundësojnë kalimin në programe profesionale ose shkencore të ciklit të dytë. **[RVV f. 52&53; Ref.1.01_EN; Ref.3.14_EN]** Studentët e ciklit të parë dhe të dytë pohuan se programet e ciklit të parë ofrojnë nivele njohurish bazë, metoda të përgjithshme shkencore dhe parime që u bëjnë të mundur studentëve të përfundojnë me sukses programin e ciklit të parë dhe të vijojnë me studime të mëtejshme. **[M 1&2]** Përfshirja e stazheve profesionale në programet e ciklit të parë u siguron studentëve përvojë të vlefshme pune dhe mundësi punësimi në të ardhmen. Partnerët e jashtëm konfirmuan se studentët, të cilët përfundojnë me sukses një stazh, përgjithësisht kalojnë në punësim të plotë pas përfundimit të programit përkatës. **[M.12]** Statuti dhe rregulloret e UPT-së u mundësojnë studentëve

transferimin ndërmjet programeve dhe nga institucione të tjera të arsimit të lartë. **[RVV f. 53; Ref.1.01_EN] (Kapitulli I, Standardi I.7)**

- Studentët e ciklit të parë kanë akses në një proces orientimi progresiv, që fillon përpara diplomimit në shkollë të mesme, përmes informacionit të mundësuar në faqen e internetit të UPT-së dhe panairëve dhe fushatave të rekrutimit. **[RVV f. 53&54; Ref.3.06_En; www.upt.al] Në ditën e parë në UPT, studentët mirëprehen me një prezantim mirëseardhjeje nga dekanët e fakultetit që mbulojnë strukturën e fakultetit, si dhe prezantohen me rregullat dhe rregulloret e përgjithshme të institucionit, që pasohet me një prezantim më të fokusuar në program nga kujdestarët e tyre të programit. Sekretarët Mësimorë ofrojnë informacion orientues për bibliotekat dhe objektet e tjera. **[RVV f. 53&54; M 3-5]** Programet e ciklit të parë përmbajnë një larmi metodash mësimore në varësi të strukturës së programit, ku përfshihet puna laboratorike, vendosjet, projektet dhe, gjatë vitit 2020, rritja e përdorimit të mësimin në distancë. **[RVV f. 53&54; M 3-7&12]** Rregulloret e UPT-së përcaktojnë kërkesat e kualifikimit për stafin akademik, ku kualifikimi minimal është diploma Master Shkencor. **[RVV f. 53&54; Ref.1.01_EN; M 6&7]** Përafërsisht 75 për qind e stafit me kohë të plotë janë të angazhuar në mësimdhënien e studentëve të ciklit të parë. **[RVV f. 54; Ref.3.12_EN] (Kapitulli I, Standardi I.8)****

- Stafi akademik që jep mësim në programet e ciklit të dytë duhet të ketë një kualifikim minimal në nivelin e doktoraturës **[RVV f. 54; Ref.1.12_EN; Ref.6.04_EN]** Ndërsa prioriteti i stafit akademik është mësimdhënia dhe kërkimi, ata janë të përfshirë në një sërë veprimtarish të tjera duke përfshirë hartimin e programeve të studimit, përgatitjen e raporteve të vetëvlerësimit, punën e komisioneve, praktikën profesionale dhe ndërlidhjen me partnerë të jashtëm. **[RVV f. 54-56; Ref.3.12_EN; M 4,5&12]** Programet Master i Shkencave dhe disa programe Master Profesional përfshijnë një tezë si provim përfundimtar për të testuar aftësitë profesionale dhe kompetencën e studentëve në fushën përkatëse inxhinierike. Sipas rastit, ofruesit e jashtëm të praktikës marrin pjesë në procesin e vlerësimit të studentëve. **[RVV f. 55; Ref.2.19_EN; M 4-7&12] (Kapitulli I, Standardi I.9)**

- UPT-ja siguron që të gjitha programet e studimit përpilohen dhe zhvillohen sipas procesit të Bolonjës dhe vlerësohen në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Akumulimit të Krediteve (ECTS), kreditet e fituara në UPT dhe jashtë vendit njihen në Rregullore. **[RVV f. 56-58; Ref.1.12_EN; Ref.1.15_EN; M 6&11]** Si të tilla, programet e studimit lehtësojnë mobilitetin dhe bashkëpunimin e studentëve dhe stafit me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë. **[RVV f. 56-58; Ref.2.08_EN; Ref.3.32_EN; Ref.5.03_EN; M 6&11]** Studentëve të suksesshëm të ciklit të parë dhe të dytë u jepet një diplomë dhe suplement diplome në shqip dhe anglisht **[RVV f. 57; Ref.3.14-EN; Ref.3.15-EN; Ref.3.16-EN; Ref.3.17-EN; Ref.3.18-EN]**. Programet duhet të përfshijnë një element të gjuhës së huaj dhe studentët mund të zgjedhin anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht ose spanjisht. **[RVV f. 57; Ref.1.01_EN; M 3-5] (Kapitulli I, Standardi I.10)**

- Mundësitë profesionale dhe të stazhit përfshihen në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë. Sipas rastit, hartimi dhe përmbajtja e programit i përgatit studentët për mundësi profesionale dhe të stazhit. **[RVV f. 58; Ref.2.24_EN; M 1,2,6&12]** Integrimi i zbatimit praktik dhe njohurive teorike në programet e studimit arrihet përmes rasteve studimore, punës laboratorike, detyrave praktike dhe projekteve, praktikës profesionale dhe tezës përfundimtare ose projektit

kërkimor. Studentët lëvduan stafin akademik për mbështetjen e ofruar gjatë gjithë studimeve të tyre. **[M 3-5]** UPT mbështet nismat sociale dhe aktivitetet e organizuara nga klube të ndryshme studentore. Për shembull, Shoqata Sportive Studentore koordinon aktivitetet vjetore sportive në institucion, të cilat kërkojnë mbështetje **[RVV f. 58; Ref.2.11_EN; Ref.3.34_EN]** (*Kapitulli I, Standardi I.11*)

- Programet e ciklit të parë dhe të dytë përfshijnë module që lidhen drejtpërdrejt me punësimin dhe zhvillimin e programeve të Masterit Profesional janë një përpjekje e drejtpërdrejtë për t'i ofruar tregut të punës të diplomuarve njohuri dhe mirëkuptim ndërdisiplinor. **[RVV f. 59; M 6&11]** Studentët treguan se stazhet janë të rëndësishme për ta, për të kuptuar aplikimin e teorisë në praktikë si dhe aftësitë e punësimit. **[M 3-5]** Turi në burimet e të nxënit i identifikuar brenda laboratorëve dhe pajisjeve të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit është krijuar posaçërisht për të ndihmuar trajnimin praktik të studentëve. **[Turi në burimet e të nxënit]** Partnerët e jashtëm janë të përfshirë në ofrimin e stazheve, vlerësimin e studentëve, këshillimin mbi përmbajtjen e kursit dhe zhvillimin e programeve të reja. **[M12]** (*Kapitulli I, Standardi I.12*)

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë në këtë Fushë Vlerësimi.

Pikat e dobëta

Grupi i vlerësimit nuk identifikoi asnjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandimet

Grupi i vlerësimit nuk bëri asnjë rekomandim lidhur me këtë Fushë Vlerësimi.

Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë pohim të veprimeve të ndërmarra në këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

- UPT ka një proces të zhvilluar mirë dhe të përcaktuar qartë për hartimin dhe rishikimin e programit. **[RVV f. 61-63; Ref.1.01_EN]** Senati Akademik shqyrton dhe miraton në fillim të çdo viti akademik planet mësimore për çdo program studimi, bazuar në propozimet e Njësive Bazë. **[RVV f. 61-63; Ref.1.01_EN; Ref.1.18_EN; Ref.4.02_EN; Ref.4.03; M 6,7,11&13]** Në fund të çdo viti akademik, departamentet rishikojnë programet e tyre dhe identifikojnë fushat për përmirësime të mëtejshme, duke përfshirë listat e literaturës për çdo modul kursi. Procesi i rishikimit të programit të studimit realizohet nga stafi akademik i departamentit siç përcaktohet në rregullore. **[RVV f. 61-63; M 6,7,11&13]** Çdo fakultet është përgjegjës për planifikimin e orëve mësimore të stafit dhe planin e saktë të punës për vitin akademik. **[RVV f. 61-63; Ref.1.01_EN; M 6,7,11&13]** Turi në burimet e të nxënit nxori në pah se institucioni ofron kapacitete të mjaftueshme për studentët e tij. Krahas bibliotekës qendrore të universitetit në kampusin kryesor, në çdo fakultet ka biblioteka. Departamentet përkatëse sigurojnë aksesin dhe saktësinë e informacionit të ofruar për studentët. **[RVV f. 61-63; Ref.4.02_EN; Ref.4.05_EN; M 6&11 Turi në burimet e të nxënit].** UPT-ja është në gjendje të realizojë procesin mësimor kryesisht në ambientet e veta. Rrjeti i punëdhënësve i ngritur nga UPT-ja dhe fakultetet individuale siguron që nëpërmjet marrëveshjeve të partneritetit studentët të mund të ndërmarrin të nxënit praktik të bazuar në punë. **[RVV f. 61-63; M 3-4,6&12] (Kapitulli I Standardi II.1)**
- Rregullat dhe kërkesat në lidhje me provimin përfundimtar të diplomës përcaktohen në statut dhe rregulloret e provimit. **[RVV f. 63&64; Ref.1.01_EN; Ref.3.14-3.19_EN; M 6]** UPT siguron që kriteret dhe procedurat në lidhje me diplomën përkatëse të zbatohen në përputhje me rregulloret përkatëse. Informacioni i diplomës vendoset në këndin e njoftimeve të fakulteteve dhe publikohet online në faqen zyrtare të UPT-së. **[RVV f. 63&64; M 3-5,6,7&11.** Ankesat ose kërkesat në lidhje me rezultatet e provimeve shqyrtohen nga një komision i ngritur në përputhje me rregulloret përkatëse. **[RVV f. 63&64; Ref.1.01_EN; Ref.3.14_EN-3.19_EN; M 3-5&6]** Studentët konfirmuan se ata janë në gjendje të konsultojnë faqet e internetit të fakultetit për një kalendar provimesh, kërkesat e diplomimit, udhëzimet për procedurat e vlerësimit dhe çdo informacion tjetër lidhur me vlerësimin, duke përfshirë rezultatet e tyre personale të provimit, nëpërmjet futjes së emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit në sistemin online të UPT-së. **[RVV f. 63&64; Ref.4.08_EN; Ref.4.09_EN; M 3-5]** Rregullat, kriteret e vlerësimit dhe specifikimet e provimeve, përcaktohen në programin e secilit modul. **[SER pp63&64; Ref.3.14-3.19_EN; M 3-5] (Kapitulli I Standardi II.2)**
- UPT ka ngritur një Këshill të Programeve të Studimit në nivel departamenti për çdo program studimi. **[RVV f. 64&65; Ref.3.13_EN; M 6]** Leksionet vlerësohen rregullisht nga strukturat e departamentit dhe fakultetit si pjesë e procesit të rishikimit të programit të studimit dhe studentët pohojnë se janë marrë parasysh pikëpamjet e tyre. **[RVV f. 64&65; Ref.1.13_EN; Ref.2.13_EN; M 3-5,7&8]** Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies ruhet edhe nëpërmjet mobilitetit të stafit, rekrutimit të stafit akademik, promovimit të stafit, lejeve sabbatike dhe angazhimit të stafit akademik në projekte kërkimore. UPT gjithashtu organizon grupe kërkimore shkencore si një mjet për të inkurajuar rekrutimin e stafit akademik me tituj akademikë të fituar përmes veprimtarive kërkimore. **[RVV f. 65&66; Ref.1.13_EN; Ref.2.04_EN; Ref.2.08_EN; M 7&8]** Senati Akademik ka përcaktuar standardet e rekrutimit për stafin akademik ndërsa departamentet vendosin kriteret në varësi të specifikimeve të rekrutimit. **[RVV f. 65&66; Ref.1.01_EN; M 6&11]** Raporti i

Vetëvlerësimi konstatoi se krahas proceseve të vlerësimit në nivel departamenti, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përgatit periodikisht pyetësorët dhe ndërmerr vlerësimin statistikor të programeve të studimit për të plotësuar procesin e vlerësimit. **[RVV f. 65; M 3-5,7&13]** Duke pranuar se UPT ka punuar drejt përmirësimit të sistemeve të saj të brendshme të cilësisë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë nuk është ngritur ende plotësisht në nivel fakulteti dhe e vuri në dukje këtë si një **pikë të dobët** sipas **Kapitullit III, Standardi I.4. (Kapitulli I Standardi II.3; Kapitulli I Standardi II.4)**

- Fushat prioritare për kërkimin shkencor janë përcaktuar në *Planin Strategjik, 2019-2024*, i cili adreson plotësisht rekomandimin e bërë pas vizitës së akreditimit të shtatorit 2016 për të pasur një qasje strategjike institucionale ndaj punës shkencore e cila mbështet stafin akademik në punën e kërkimit shkencor. **[RVV f. 11,12&69-73; Ref.1.12_EN]** Departamentet, si njësi bazë, vendosin prioritetet e veta të kërkimit, në përputhje me Planin Strategjik të UPT-së. **[RVV f. 66-68&70-71; Ref.1.01_EN; M 6&11]** UPT-ja nxit stafin që të angazhohet dhe të marrë pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Stafi akademik pohoi se UPT-ja mbështet pjesëmarrjen e tyre në aktivitete ndërkombëtare. **[M 6&11]** Departamentet paraqesin propozime për prioritetet e kërkimit, duke përfshirë aspektet financiare, të cilat më pas miratohen nga Rektorati. **[RVV f. 66; Ref.1.01_EN; Ref.1.11_EN; Ref.1.14_EN; Ref.4.10_EN, M 6&11]** UPT punon në bashkëpunim me institucione kërkimore publike dhe private, për të mundur përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së procesit mësimor dhe kërkimit shkencor. **[RVV f. 68&69; Ref.1.12_EN; Ref.4.18_EN; M 6&11]** Çdo vit, departamentet përpilojnë një listë të veprimtarive dhe publikimeve të tyre shkencore dhe UPT-ja siguron që laboratorët, bibliotekat dhe objekte të tjera të mjaftueshme dhe të përshtatshme janë në dispozicion për të mbështetur zbatimin e veprimtarive të kërkimit shkencor. Çdo vit, stafi duhet të prezantojë punën e vet në të paktën një konferencë të brendshme shkencore ose të publikojë një artikull shkencor në një revistë. **[RVV f. 69-73; Ref.1.14_EN; Ref.4.15_EN; Ref.4.20_EN; M 6&11]** **(Kapitulli II Standardi I.1; Kapitulli II Standardi I.2; Kapitulli II Standardi I.4; Kapitulli II Standardi I.5)**

- Ndërkombëtarizimi i kërkimit shkencor mbetet një prioritet institucional. **[RVV f. 70; Ref.1.12_EN; M 11]** UPT ka lidhur një sërë marrëveshjesh ndërkombëtare dhe merr pjesë në kërkime shkencore me partnerë të ndryshëm. **[RVV f. 68-69; M 3-5&6]** Në kuadër të programit Erasmus, UPT-ja bashkëpunon me universitete publike dhe private në Shqipëri dhe Evropë dhe ka ngritur rrjete partnerësh për tema që kanë të bëjnë me pushtetin qendror dhe vendor, biznesin dhe ligjin dhe ekonominë kombëtare. **[RVV f. 68-69; M 3-5&6]** Studentët dhe stafi dhanë shembuj të pjesëmarrjes në konferenca dhe veprimtari kërkimore. **[M 3-5&6]** Sipas Raportit të Vetëvlerësimit është arritur sukses i konsiderueshëm në përfundimin e fondeve të jashtme për projekte ndërkombëtare, pajisje laboratorike dhe kompjuterike. **[RVV f. 69]** **(Kapitulli II Standardi I.3)**

- UPT-ja siguron vazhdimësinë në fushën e kërkimit shkencor, pasi ai është një objektiv qendror institucional. **[RVV f. 71&72; Ref.1.01_EN, Ref.1.12_EN; M 6&11]** UPT angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave shkencore rajonale dhe kombëtare të cilat publikohen në faqen zyrtare të institucionit. **[www.upt.al]** Studentët dhe stafi pohuan se UPT-ja inkurajon mundësitë e mobilitetit ndërkombëtar dhe shpesh fton staf akademik të huaj të kontribuojë duke ofruar

leksione të hapura ose duke u angazhuar si pedagogë me kohë të pjeshme. [RVV f. 71&72; Ref.1.01_EN; Ref.1.12_EN; Ref.2.08_EN; Ref.4.12_EN; Ref.4.13_EN; M 3-5&6] (Kapitulli II, Standardi I.6)

- Kërkimi shkencor drejtohet nga Drejtoria e Kërkimeve Shkencore dhe Projekteve e ndarë në tre sektorë: Sektori i Promovimit Akademik dhe Shkencor, Sektori i Botimeve Shkencore dhe Sektori i Projekteve Shkencore dhe Profesionale. Departamentet janë përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e progresit të kërkimit shkencor dhe rezultatet shpërndahen dhe vihen në dispozicion të komunitetit shkencor duke përdorur një shumëllojshmëri mediumesh duke përfshirë konferencat, prezantimet dhe botimet në revista shkencore. [RVV f. 71&72; M 5&6] Studentët pohuan se UPT-ja mbështet studiuesit e rinj në nismat dhe projektet e tyre individuale të kërkimit shkencor. Në mënyrë të ngjashme, studentët e ciklit të parë dhe të dytë treguan se nxiten të marrin pjesë në veprimtari ndërkombëtare të organizuara nga institucioni. [M 3-5] Krahas botimit të *Buletinit të Shkencave Teknike*, stafi inkurajohet të paraqesë rezultatet e kërkimit shkencor për botim kombëtar dhe ndërkombëtar. [RVV f. 71&72; Ref.2.09_EN; Ref.4.13_EN; <http://upt.al/botime>; M 1,6&11] (Kapitulli II Standardi I.7; Kapitulli II Standardi I.8)

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë në këtë Fushë Vlerësimi.

Pikat e dobëta

Grupi i vlerësimit nuk identifikoi asnjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandimet

Grupi i vlerësimit nuk bëri asnjë rekomandim lidhur me këtë Fushë Vlerësimi.

Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë pohim të veprimeve të ndërmarra në këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e Tyre

- UPT-ja ka kritere të qarta të pranimit të studentëve. [RVV f. 76&77; Ref.2.19_EN; www.upt.al] Politikat e pranimit bazohen në kuotat e pranimit, të cilat marrin parasysh infrastrukturën dhe kapacitetet e stafit. Bursat ofrohen për studentët e vitit të parë bazuar në tregues të tillë si notat e arritura ose shtresat sociale në përputhje me kërkesat e Këshillit të Ministrave. Studentët pohuan se informacioni mbi programet e studimit, objektivat e trajnimit dhe kriteret e pranimit është i disponueshëm nga Zyra e Këshillimit të Karrierës, të publikuar në faqen zyrtare të internetit si dhe vihet në dispozicion gjatë panairëve të rekrutimit dhe ditëve të hapura. [RVV f. 76&77; Ref.2.19_EN; www.upt.al; M 3-5,6&7] Në ditën e parë të programit të tyre, studentët priten nga pedagogët dhe njihen me programin përkatës. Sekretaritë Mësimore të Fakulteteve janë përgjegjëse për dhënien e informacionit të orientimit të studentëve në lidhje me bibliotekat, laboratorët dhe objektet e tjera. [RVV f. 76&77; Ref.2.10_EN; Ref.2.19_EN; Ref.3.08_EN; Ref.3.09_EN; M 3-5] (*Kapitulli I, Standardi III.1*)
- UPT ka ngritur Zyrën e Këshillimit të Karrierës e cila është struktura qendrore mbështetëse për studentët dhe ka një marrëdhënie të ngushtë me komunitetet e biznesit. [RVV f. 77; M 3-5&12] Megjithatë, siç u përmend më herët në këtë raport, zyra përbëhet nga një person. Gjithashtu, përfaqësuesit e këshillimit të karrierës në nivel fakulteti kanë një rol shtesë për sigurimin e brendshëm të cilësisë. [M 3-5,7&10] Duke pranuar se UPT-ja ka punuar drejt përmirësimit të strukturës qendrore mbështetëse për studentët dhe ka një marrëdhënie të ngushtë me komunitetin e biznesit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se Zyra e Këshillimit të Karrierës nuk është ngritur plotësisht dhe kjo përbën një pikë të dobët sipas *Kapitullit III, Standardi III.1 dhe Kapitullit III, Standardi III.2*. Sekretaritë Mësimore të Fakulteteve mbajnë dosjet individuale personale të studentëve, të cilat përditësohen gjatë periudhës së studimeve, duke përfshirë, për shembull, të dhëna për praktikën profesionale dhe tezën e diplomës. Sistemi online i UPT-së mundëson komunikimin ndërmjet studentëve dhe stafit akademik dhe administrativ si individualisht ashtu edhe në grup. Studentët konfirmuan se sistemi i brendshëm i komunikimit është efektiv. [RVV f. 77; Ref.2.10_EN; Ref.2.25_EN; Ref.5.02_EN; M 3-5,7&10] (*Kapitulli I, Standardi III.2; Kapitulli I, Standardi III.3*)
- UPT ndjek në mënyrë aktive një politikë që garanton se infrastruktura institucionale është e përshtatshme për të gjithë studentët dhe zbaton një politikë mbështetëse për kategori të veçanta sociale studentore përmes subvencionimit të tarifave të shkollimit për studentët ose prindërit e tyre me aftësi të kufizuar dhe studentët nga familje të mbështetura me ndihmë ekonomike. [RVV f. 78&79; Ref.2.40_EN; Ref.3.09_EN; Ref.5.04_EN; M 6,7,11&13] (*Kapitulli I, Standardi III.4*)
- Rrjeti i bibliotekave përbëhet nga Biblioteka Qendrore Shkencore dhe shtatë biblioteka të vendosura në Njësitë Kryesore. Studentët konfirmuan se materiali mësimor është gjithëpërfshirës dhe i përgjigjet nevojave të tyre. [RVV f. 12&13,79&80; M 3-5] Bazuar në listat e blerjeve, fondi i bibliotekës ka pasuruar burimet e tij me botime të reja të teksteve shkollore në mënyrë periodike për t'iu përgjigjur nevojave të programeve të studimit. Kjo plotësohet me materiale dhe literaturë elektronike për të ndihmuar në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të të gjitha programeve dhe kërkimit shkencor. [RVV f. 12&13,79&80; <https://ulibrary.rash.al/>;

<https://plus.al.cobiss.net/opac7/libraries>]. Krahas Bibliotekës Qendrore Shkencore bibliotekave të Njësisë Kryesore, çdo departament ka një kënd literature ose minibibliotekë specifike për lëndën. **[RVV f. 79; Ref.2.36_EN; Ref.2.37_EN; Ref.5.05_EN; M 3-5; Turi në burimet e të nxëniti]** Zhvillimi i bibliotekës elektronike dhe rritja e aksesit në libra dhe revista shkencore elektronike adreson plotësisht rekomandimin e bërë pas vizitës së parë për të përmirësuar cilësinë e literaturës në bibliotekë. **(Kapitulli I, Standardi III.5)**

- Studentët pohuan se UPT-ja ofron një gamë të gjerë mekanizmash mbështetës për studentët e ciklit të parë gjatë gjithë programit të tyre të studimit. **[RVV f. 80&81; M 3-6]** Kjo përfshin mbështetjen nga pedagogët për të aksesuar literaturën specifike dhe mbështetjen nga Sekretaritetë Mësimore të Fakultetit nëpërmjet portalit elektronik. Mentorimi i veçantë iu ofrohet studentëve të vitit të tretë të ciklit të parë, për t'i mbështetur gjatë zgjedhjes dhe hartimit të tezës së diplomës dhe për t'i këshilluar për mundësitë e punësimit në të ardhmen. Për më tepër, të gjithë studentëve të ciklit të parë u caktohet një kujdestar individual i cili ofron mbështetje dhe orientim individual gjatë gjithë programit përmes takimeve formale me orar. Sigurimi i kujdestarëve individualë për studentët e ciklit të parë është një veçori e **praktikës së mirë** në mbështetjen e ofruar për studentët e ciklit të parë nga UPT me qëllim lehtësimin e ecurisë së tyre në program. **[RVV f. 80&81; Ref.4.09_EN; Ref.5.06_EN; M 3-6; <https://bitalbania.com/>]** **(Kapitulli I, Standardi III.6)**

- Raporti i Vetëvlerësimit thekson se pjesëmarrja e studentëve në jetën institucionale të UPT-së është e rëndësishme dhe studentët e konfirmojnë këtë. **[RVV f. 81; M 3-5]** Përfaqësuesit e studentëve të cilët zgjidhen nga radhët e tyre marrin pjesë në një sërë bordesh dhe komisionesh duke përfshirë Senatën Akademikë i cili ka katër studentë anëtarë. **[RVV f. 81; M 3-5]** Studentët kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe shqetësimet e tyre për çështje që lidhen me ecurinë e procesit mësimor, duke përfshirë sesionet e provimeve. Studentët u shprehën se janë të kënaqur që u janë kërkuar dhe marrë seriozisht mendimet, dhe që aty ku është menduar si praktike apo e arsyeshme, janë ndërmarrë veprime të efektshme. **[RVV f. 81; Ref.1.01_EN; Ref.5.09_EN; Ref.5.10_EN; M 3-5&11]** **(Kapitulli I, Standardi III.7)**

- Veprimtaritë sociale dhe kulturore, duke përfshirë sportin, përbëjnë një pjesë të rëndësishme të përvojës së studentëve në UPT. **[RVV f. 81&82; M 3-7&11]** Karta e studentit u mundëson studentëve të aksesojnë një sërë shërbimesh private dhe publike në nivel vendor. **[RVV f. 81]** Gjithashtu, ofrohen mundësi për ndërveprim social të studentëve nëpërmjet zhvillimit të aftësive drejtuese dhe veprimtarive të ndryshme argëtimi dhe shërbimeve në komunitet. **[RVV f. 81]** Studentët kanë akses në Shoqatën Sportive Studentore të UPT-së, e cila u mundëson studentëve të marrin pjesë në Kampionatin Kombëtar Studentor të zhvilluar çdo vit në katër disiplina (Volejboll Femra, Minifutboll Meshkuj, Basketboll Meshkuj dhe Futboll Meshkuj). Shoqata Sportive Studentore është një nga anëtarët themelues të Federatës Shqiptare të Sportit Universitar. **[RVV f. 81&82; Ref.3.34_EN; M 3-5]** **(Kapitulli I, Standardi III.8)**

- UPT ofron mbështetje dhe ndihmë për t'u mundësuar studentëve të punësohen në përfundim të programeve të tyre përmes organizimit të workshop-eve, panairove të punës dhe mundësive të praktikës profesionale për t'i prezantuar studentët me tregun e punës. **[RVV f.**

82&83; M 3-6,10&12] Siç konstatohet më lart në raport, UPT ka të dhëna për punësimin e studentëve të tij, me të cilët ruan kontakte të vazhdueshme dhe një Shoqatë Alumni për të monitoruar në mënyrë qendrore vendet dhe rezultatet e punësimit të të diplomuarve. Gjatë kohës së vizitës mbi 200 të diplomuar kishin shprehur interesin për t'u bërë pjesë e Shoqatës së Alumni. **[RVV f. 82&83; Ref.1.18_EN; Ref.1.19_EN; Ref.2.10_EN; M 10&12] (Kapitulli I, Standardi III.9)**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- sigurimi i kujdestarëve individualë për studentët e ciklit të parë për të lehtësuar ecurinë e tyre përmes programit të tyre. **(Kapitulli I, Standardi III.6)**

Pikat e dobëta

Grupi i vlerësimit nuk identifikoi asnjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandimet

Grupi i vlerësimit nuk bëri asnjë rekomandim lidhur me këtë Fushë Vlerësimi.

Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë pohim të veprimeve të ndërmarra në këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- sigurimi i kujdestarëve individualë për studentët e ciklit të parë për të lehtësuar ecurinë e tyre përmes programit të tyre. **(Kapitulli I, Standardi III.6).**

Pikat e dobëta

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë nuk është ngritur plotësisht pasi mbeten të paplotësuara disa vende vakante në nivel fakulteti **(Kapitulli III, Standardi I.4)**
- Zyra e Karrierës dhe Alumni nuk është ngritur plotësisht pasi mbeten të paplotësuara disa vende vakante **(Kapitulli III, Standardi III.1; Kapitulli III, Standardi III.2)**.

Rekomandimet

Grupi i vlerësimit të jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- UPT-ja trajton si çështje parësore ngritjen e plotë dhe nivelet e personelit të kërkuara për mbështetjen e një Njësie plotësisht funksionale të Sigurimit të Cilësisë së Brendshme në mbarë institucionin. **(Kapitulli III, Standardi I.4)**
- UPT-ja trajton si çështje parësore ngritjen e plotë dhe nivelet e personelit të kërkuara për mbështetjen e një Zyre plotësisht funksionale të Karrierës dhe Alumni në mbarë institucionin. **(Kapitulli III, Standardi III.1; Kapitulli III, Standardi III.2)**
- UPT-ja vijon të zhvillojë strategjinë e saj të ndërkombëtarizimit për të siguruar që mundësitë e mobilitetit për stafin dhe studentët dhe integrimi i studentëve dhe stafit të huaj të mund të realizohen në mënyrë të efektshme. **(Kapitulli III, Standardi III.4)**
- UPT-ja siguron që të gjitha faqet e internetit të fakulteteve monitorohen rregullisht në nivel institucional për të siguruar që informacioni i ofruar është konsistent, i qartë, i përditësuar dhe i saktë. **(Kapitulli III, Standardi VII.1)**.

Konfirmimi i veprimit të ndërmarrë

Grupi i vlerësimit të jashtëm pohoi veprimin e mëposhtëm të ndërmarrë:

- promovimin e trajnimeve të mëtejshme profesionale afatshkurtra në bashkëpunim me rrjetin e partnerëve të jashtëm; **(Kapitulli III, Standardi III.1; Kapitulli III, Standardi III.2)**
- masën e propozuar nga UPT-ja për sigurimin se të gjithë studentët, dhe personat me aftësi të kufizuara në veçanti, do të kenë akses të plotë dhe të pakufizuar në hapësirat e institucionit. **(Kapitulli III, Standardi VII.3; Kapitulli III, Standardi VII.5; Kapitulli III, Standardi V.1)**.

Gjykimi

Gjykime përmbledhëse për çdo Fushë Vlerësimi

- Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur kryesisht.
- Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.
- Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.
- Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur plotësisht.

- Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e Tyre janë përmbushur plotësisht.

Gjykim i përmbledhur

Vlerësuesit i rekomandojnë Këshillit të Akreditimit se Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur plotësisht në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Lista e evidencave

Lista 1

Dokumentet në këtë listë janë dorëzuar nga institucioni për të shoqëruar raportin e vetëvlerësimit dhe për t'u shfaqur në sistemin e menaxhimit ASCAL gjatë fazës së vetëvlerësimit të procesit. Në raport këto dokumente referohen si **Ref.1.01_EN, Ref.1.02_EN, etj.**

- 1.01_EN Statuti i UPT-së.
- 1.02_EN Struktura organizative e UPT-së.
- 1.03_EN Rregullore e komisionit për ngritjen në kategori të Stafit Akademik në UPT.
- 1.04_EN Rregullore e Komisionit të Përhershëm të UPT-së për dhënien e titullit "Doktor i Shkencave".
- 1.05_EN Rregullore për funksionimin e Bordit të Administrimit të UPT-së.
- 1.06_EN Kodi i Etikës së UPT-së.
- 1.07_EN Rregullore për marrjen e titujve akademikë në UPT.
- 1.08_EN Rregullore e UPT-së për Studimet e Doktoraturës.
- 1.09_EN Rregullore për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese 2020-2024
- 1.10_EN Model i Rregullores për Njësinë Kryesore.
- 1.11_EN Model i Rregullores për Njësinë Bazë.
- 1.12_EN Plani Strategjik 2019-2024, UPT.
- 1.13_EN Raporti i veprimtarisë mësimore (në nivel universiteti dhe njësie).
- 1.14_EN Raporti i veprimtarisë së kërkimit shkencor (në nivel universiteti dhe njësie).
- 1.15_EN Plani strategjik i njësisë kryesore dhe njësisë bazë.
- 1.16_EN Njësitë bazë në UPT.
- 1.17_EN Kualifikimet e stafit akademik në njësitë bazë.
- 1.18_EN Marrëveshje ndërkombëtare.
- 1.19_EN Marrëveshje me industrinë dhe institucionet.
- 1.20_EN Marrëveshje për diplomat e dyfishta ose programet e përbashkëta.
- 1.21_EN Staf akademik i huaj i ftuar.
- 1.22_EN Plani i Veprimit për përmbushjen e rekomandimeve të Bordit të Akreditimit.
- 1.23_EN Plani i Veprimit për problemet e identifikuara në Sondazhet e Studentëve.
- 1.24_EN Trajnimi i stafit të Zyrës së Sigurimit të Cilësisë.
- 1.25_EN Vendimi për mbylljen e programeve të studimit.
- 1.26_EN Sondazhet e tregut të punës dhe shoqërive.
- 1.27_EN Shkëmbimet e literaturës, 2017-2020.

- 2.01_EN Miratimi i Strukturës së UPT-së.
- 2.02_EN Stafii me kohë të plotë i UPT-së.
- 2.03_EN Të dhëna për stafin akademik, stafin mbështetës dhe personelin administrativ.
- 2.04_EN Procedurat e punësimit në UPT.
- 2.05_EN Praktikatat e punësimit në UPT.
- 2.06_EN Punësimi i stafit akademik me kohë të plotë për vitet 2017-2020.
- 2.07_EN Evidenca për trajnimin e stafit në UPT.
- 2.08_EN Mobilitetet 2017-2020.
- 2.09_EN Projektet dhe veprimtaritë kërkimore në njësitë bazë dhe kryesore.
- 2.10_EN Veprimtaritë e organizuara nga Zyra e Karrierës.
- 2.11_EN Aktivitetet sociale.
- 2.12_EN Shembulli i parashikimit të ngarkesës mësimore.
- 2.13_EN Sondazhi Studentor - Pyetësori dhe Raporti.
- 2.14_EN Rregullore e Buletinit të Shkencave Teknike.
- 2.15_EN Evidenca për kontributin në zhvillimin shoqëror dhe kombëtar.
- 2.16_EN Lista e shërbimeve të ofruara palëve të treta.
- 2.17_EN Shërbime të kryera për palë të treta.
- 2.18_EN Certifikimi sanitar dhe i sigurisë ndaj zjarrit.
- 2.19_EN Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Procesit Mësimor të UPT-së.
- 2.20_EN Buxheti Afatmesëm 2020-2022.
- 2.21_EN Evidenca të projektbuxhetit në nivel të njësisë kryesore/bazë.
- 2.22_EN Tabela e të ardhurave dhe investimeve 2017-2020.
- 2.23_EN Rregullore e Disiplinës dhe Sistemit të Shërbimit në UPT.
- 2.24_EN Karta e praktikës.
- 2.25_EN Informimi i studentëve nëpërmjet platformave elektronike.
- 2.26_EN Vlerësimi dhe mirëmbajtja e dokumentacionit të performancave të studentëve.
- 2.27_EN Procedurat e prokurimit për pajisje (Biblioteka Shkencore).
- 2.28_EN Infrastruktura Fizike e UPT-së.
- 2.29_EN Polica e sigurimit.
- 2.30_EN Rrjeti i Stacioneve IGEWE.
- 2.31_EN Informacion për godinat.
- 2.32_EN Financim për rindërtim dhe godina të reja.
- 2.33_EN Rregullore e Bibliotekës Shkencore.
- 2.34_EN Pasurimi i Arkivit Shkencor 2017-2020.
- 2.35_EN Të dhëna mbi diplomatat dhe titujt e dhënë në UPT gjatë periudhës 2017-2020.
- 2.36_EN Pasurimi i fondit të Bibliotekës Shkencore 2017-2020.
- 2.37_EN Informacion për Bibliotekat në UPT.
- 2.38_EN Hapësirat e reja në dispozicion të fakulteteve.
- 2.39_EN Laboratorët e UPT-së.
- 2.40_EN Plani i Veprimit për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar.
- 2.41_EN Numri i studentëve aktivë, 2019-2020.
- 2.42_EN Informacion për Zyrën e Statistikave.
- 2.43_EN Modeli i regjistrimit.
- 3.01_EN Njësitë bazë dhe programet e studimit që ato ofrojnë.
- 3.02_EN Numri i programeve të studimit sipas njësive kryesore.
- 3.03_EN Programet aktive të studimit 2020 - 2021.
- 3.04_EN Praktika për riorganizimin dhe rishikimin e Programeve të Studimit.
- 3.05_EN Informacion për broshurat, udhëzuesit e studentëve.
- 3.06_EN Veprimtaritë e informimit për programet e studimit.

- 3.07_EN Rregullore e pranimeve në FAU.
- 3.08_EN Miratimi i kriterëve të pranimit në UPT.
- 3.09_EN Kuotat e pranimit 2020-2021.
- 3.10_EN Raport për kapacitetet pritëse të UPT-së.
- 3.11_EN Investime në pajisje laboratorike 2017-2020.
- 3.12_EN Dokumentacioni i ngarkesës mësimore.
- 3.13_EN Procedura e miratimit për një program të ri studimi.
- 3.14_EN Dokumentacioni i plotë i një programi studimi (Cikli i parë).
- 3.15_EN Dokumentacioni i plotë i një programi studimi (Cikli i dytë MP 60 kredite ECTS).
- 3.16_EN Dokumentacioni i plotë i një programi studimi (Cikli i dytë MP 120 kredite ECTS).
- 3.17_EN Dokumentacioni i plotë i një programi studimi (Cikli i dytë MSH 120 kredite ECTS).
- 3.18_EN Dokumentacioni i plotë i një programi studimi (Cikli i dytë MSH 300 kredite ECTS).
- 3.19_EN Dokumentacioni i plotë i një programi studimi (Cikli i tretë).
- 3.20_EN Këshillat dhe Koordinatorët e Programeve të Studimit.
- 3.21_EN Dokumentacioni i plotë i një programi të nxënies të vazhdueshëm.
- 3.22_EN Pyetësor për organizimin e programit të edukimit të vazhdueshëm.
- 3.23_EN Vendim i Senatit për nivelin e gjuhëve të huaja.
- 3.24_EN Procedura për përlogaritjen e ngarkesës mësimore.
- 3.25_EN Praktika e transferimit të studimeve.
- 3.26_EN Përmbledhje e realizimit të ngarkesës mësimore.
- 3.27_EN Praktika mësimore e studentit në UPT.
- 3.28_EN Udhëheqje për temat e tezave.
- 3.29_EN Shembuj të rregulloreve për procesin e diplomimit.
- 3.30_EN Pyetësor dhe Baza e të dhënave të studentëve të diplomuar.
- 3.31_EN Udhëzuesi i Programit të Studimit.
- 3.32_EN Procedura e mobilitetit për studentët.
- 3.33_EN Veprimtaritë studentore në UPT.
- 3.34_EN Veprimtaritë sportive studentore.

- 4.01_EN Kualifikimi i stafit mbështetës akademik në FIE.
- 4.02_EN Struktura vjetore e procesit mësimor në UPT.
- 4.03_EN Publikimi online i kalendarit akademik.
- 4.04_EN Forma të tjera të mësimdhënies (Studio Projektimi).
- 4.05_EN Evidenca të punës laboratorike.
- 4.06_EN Shembull të grupit të punës për një projekt.
- 4.07_EN Udhëzues dhe manual për zhvillimin e mësimit në distancë.
- 4.08_EN Komisioni i provimeve dhe vlerësimit të tezës së diplomës.
- 4.09_EN Akses online në sekretari nga studentët.
- 4.10_EN Fushat e miratuara të kërkimit në UPT.
- 4.11_EN Planifikimi buxhetor në nivel departamenti.
- 4.12_EN Plani vjetor i veprimtarisë kërkimore në njësitë bazë dhe kryesore.
- 4.13_EN Veprimtari të kërkimit shkencor në UPT.
- 4.14_EN Evidenca për financimin e Kërkimit shkencor.
- 4.15_EN Projektit e kërkimit të departamenteve të financuara nga UPT-ja.
- 4.16_EN Financimi për pjesëmarrje në veprimtari kërkimore, 2017-2020.
- 4.17_EN Veprimtari kërkimore IGEWE.
- 4.18_EN Projekte kërkimore në UPT.
- 4.19_EN Përfshirja e studentëve në veprimtari kërkimore.
- 4.20_EN Fonde nga Projekte Ndërkombëtare.
- 4.21_EN Vendim për riorganizimin e programeve të Ciklit të Tretë.
- 4.22_EN Bashkëpunimi IGEWE me departamentet.

- 4.23_EN Blerja e pajisjeve laboratorike për njësitë kryesore.
- 4.24_EN Marrëveshje me Akademinë e Shkencave.
- 4.25_EN Kontrolli kundër plagjiaturës.

- 5.01_EN Të dhëna për numrin e studentëve të huaj.
- 5.02_EN Shembull i dosjes së studentit.
- 5.03_EN Procedurat për mobilitetin e programit Erasmus+.
- 5.04_EN Të dhëna për studentët që përfitojnë ndihmë ekonomike.
- 5.05_EN Karta e Bibliotekës Shkencore.
- 5.06_EN Kujdestaria (tutorati).
- 5.07_EN Vendime për heqjen e pagesave për shërbime ndaj studentëve.
- 5.08_EN Rezultatet e zgjedhjeve për Senatit Akademik.
- 5.09_EN Këshilli Studentor (Veprimtaritë).
- 5.10_EN Rregullore e Këshillit Studentor.
- 5.11_EN Financimi i veprimtarive studentore në UPT.
- 5.12_EN Karta e studentit.

Lista 2

Dokumentet në këtë listë iu paraqitën institucionit pas kërkesës së Grupit të Vlerësimit të Jashtëm për të qartësuar dokumentet fillestare mbështetëse dhe për t'i hedhur në faqen e menaxhimi të ASCAL-it në fazën e vlerësimit të dokumentacionit të procesit. Në raport, këto dokumente referohen si **6.01**, **6.02**, etj.

- 6.01 Procesverbalet e mbledhjeve të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit.
- 6.02 Shembuj të veprimtarisë ditore të Zyrës së Sigurimit të Cilësisë.
- 6.03 Trajnimi i stafit të Zyrës së Sigurimit të Cilësisë.
- 6.04 Raport për analizën e veprimtarisë mësimore, veprimtarisë së kërkimit shkencor dhe veprimtarisë financiare.
- 6.05 Raport për gjurmimin e punësimit të të diplomuarve nga UPT-ja.
- 6.06 Raporti i Auditit të Brendshëm të UPT-së.

Mbledhjet e zhvilluara gjatë vizitës

Në raport, mbledhjeve u referohen duke përdorur shkurtime **M 1**, **M 2**, etj:

Dita 1: E enjte 1 prill 2021

- 09:00 -09:15 Mbledhja 1: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon Koordinatorin Institucional.
- 09:15 - 09:45 Mbledhja 2: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon Rektorin.
- 10:00 - 11:00 Mbledhja 3: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon një grup studentësh të ciklit të parë.
- 11:15 - 12:15 Mbledhja 4: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon një grup studentësh të ciklit të dytë.
- 12:30 - 13:15 Mbledhja 5: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon një grup studentësh të ciklit të tretë.
- 14:30 - 15:30 Mbledhja 6: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon një grup të stafit akademik.

- 16:00 – 17:00 Mbledhja 7: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon një grup të stafit mbështetës.
- 17:15 – 17:45 Mbledhja 8: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

Dita 2: E premte 2 prill 2021

- 09:00 – 09:15 Mbledhja 9: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon Koordinatorin Institucional.
- 09:15 – 10:15 Mbledhja 10: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumni.
- 10:30 – 11:30 Mbledhja 11: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon drejtuesit e lartë.
- 11:45 – 12:15 Mbledhja 12: Mbledhja me partnerë të jashtëm dhe alumni
- 12:30 – 13:30 Grupi i vlerësimit të jashtëm takon Grupin e Vetëvlerësimit
- 13:45 – 14:00 Mbledhja 13: Grupi i vlerësimit të jashtëm takon Koordinatorin Institucional.
- 14:00 – 14:15 Mbledhja 14: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takon Rektorin